# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-458688**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Mbi 400 kg hashash kapen të fshehura në valixhe dhe frigoriferë/ Arrestohet shqiptari në Itali |
| ADRESA | `https://www.cna.al/kronika/kapen-mbi-400-kg--ne-valixhe-e-frigorifere-arrestohet-29-vjecari--i474667` |
| BURIMI | cna.al |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 19 shtator 2026, 19:46:24 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 19 shtator 2026, 19:44:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `5861cac9eddd073f7b87be9265f6d19f61021beca6296aba07e7172c3caaffed` |
| TEKSTI | `840c72f7c014678536644ff3e3cf2fc9b9e38844abe46cbfde4c2ff25c35f1f6` |
| PAMJA | `041a046e188f55aa614525a3d9efa535a90aa8b73c2aa81c27833f3de6ed631a` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `23960b94bc59e0a69b677748f56a036e1b62ecfeba42df6d58cde5751876943a` |
| E MËPARSHMJA | `05ec3a1e5c26332528b6069c7299ff54a4fc3a3c03967b8693e68f050c3004e9` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/23960b94bc59e0a69b677748f56a036e1b62ecfeba42df6d58cde5751876943a`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

## E fundit!

x

22:06 Aktualitet

Banorët e Divjakës vijojnë prej 51 ditësh radhazi të prote...

# Mbi 400 kg hashash kapen të fshehura në valixhe dhe frigoriferë/ Arrestohet shqiptari në Itali

19 Shtator 2026, 21:44, Kronika CNA




Mbi 414 kilogramë hashash janë sekuestruar nga policia italiane gjatë një operacioni antidrogë në Guidonia Montecelio, pranë Romës, ku u vu në pranga një 29-vjeçar shqiptar. Droga e sekuestruar, nëse do të hidhej në treg, do të mund të gjeneronte më shumë se 4 milionë euro fitime.

Ky i fundit u kap në momentin kur po përpiqej të ngarkonte në bagazhin e makinës së tij disa valixhe të mëdha. Pikërisht brenda valixheve, efektivët e policisë gjetën 98 kilogramët e parë të hashashit.

Hetuesit u drejtuan më pas te sasitë e tjera nga një tufë çelësash që posedonte i riu. Çelësat rezultuan të ishin për një seri magazinash në zonën mes Guidonias dhe Romës.

Kontrollet e nisura më pas zbuluan gradualisht një rrjet të vërtetë logjistik për ruajtjen e drogës. Pas dyerve që hapeshin me këta çelësa, policët gjetën sasi të mëdha hashashi, së

bashku me materiale të nevojshme për paketimin e tij.

Një pjesë e konsiderueshme e drogës mbahej “në të ftohtë”, brenda frigoriferëve të përdorur si ambiente të vërteta magazinimi.

Bashkë me lëndën narkotike, hetuesit gjetën gjithashtu edhe shënime të shkruara me dorë, që përmbanin të dhëna mbi sasitë e supozuara të drogës që ishin lëvizur.

Sekuestrimi i përgjithshëm arriti në më shumë se 414 kilogramë hashash, së cilës iu shtuan edhe materialet që konsiderohen të nevojshme për përgatitjen dhe paketimin e lëndës narkotike. Droga e sekuestruar, nëse do të hidhej në treg, do të mund të gjeneronte më shumë se 4 milionë euro fitime.

29-vjeçari shqiptar u arrestua për veprën penale të mbajtjes së lëndëve narkotike me qëllim shpërndarjen. Gjykata caktoi ndaj tij masën e sigurisë “arrest me burg”. **/CNA**







---

# Të sugjeruara

## [Falsifikim i dokumenteve dhe përfitim i padrejtë i pronave në Fier/ Ekzekutohen 3 masa të tj sigurie]

**Vrau me thikë bashkëshorten/ Kapet 68-vjeçari**

**Krimi në familje/ Policia: Ngjarja ndodhi pas një konflikti në banesë**

**E rëndë në Tiranë/ Burri vret gruan, largohet nga vendngjarja**

**Të shtëna me armë zjarri në Tiranë/ Plagoset një person**

**Sekuestrohen mbi 414 kilogramë drogë/ Në pranga një shtetas shqiptar, ja ku u gjet sasia**

**Rrugorja e Tiranës "kërcet" gjobat/ Rreth 7 mijë ndëshkime, arrestohen 7 shoferë**

**I riu shkodran rrëshqet në lokal dhe dëmton kokën/ Me helikopter drejt Traumës**

**Kapet në Peshkopi i kërkuari nga Italia/ 40-vjeçari shqiptar drejt ekstradimit**

**Me akuza e dënime për tentativë vrasjeje/ Arrestohen në Itali 2 shqiptarë**

**U shoqëruan dje në komisariat/ Lirohen 25 protestuesit**

**Aksident i rëndë në Athinë/ Përmbyset makina, viktima 3 të rinj shqiptarë**

**Lojëra fati dhe kanabis në lokal/ Arrestohet në flagrancë 47-vjeçari në Koplik, administratori në kërkim**

**Lokale me lojëra fati në afërsi të shkollave/ Arrestohen 2 persona, 2 të tjerë në procedim**

**Nuk u kthye në burg pas lejes/ Alket Rizai dyshohet se ka ardhur në Shqipëri**

**Tensionet dhe përplasjet te Parlamenti/ Shoqërohen 25 protestues**

**Pësoi arrest kardiak në det/ Humb jetën 82-vjeçari**

**Falsifikime dhe shpërdorim detyre/ Pezullohen 2 zyrtarë në Tiranë, 1 në kërkim**

**Vodhi me thyerje 16 lokale/ Pranga 34-vjeçarit në Tiranë, kishte arrest shtëpie**

**Konflikti me thika mes të rinjve në Sarandë/ Policia jep detaje për ngjarjen**

## editorial

15:14 Editorial

**Katër burra që hynë në histori dhe një kryetar bashkie që nuk di të dalë nga karrigia**

**CNA LIVESTREAM**

Na ndiqni edhe në

## acromax

19:53 Acromax / Aldor Nini

**Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH**

## opinion

11:47 Opinione Luçiano Boçi

**TË RROFTË EMRI…**

21:11 Opinione Lutfi Dervishi

**Orët e Tiranës**

17:02 Opinione Belind Këlliçi

**Bëhu si Roni të kesh sukses në Shqipëri!**

## Lifestyle

07:38 Lifestyle

**Nga Europa në SHBA/ Ja cilat janë qytetet më të mira të botës**

Qytetet evropiane dhe të Amerikës së Veriut dominojnë Inde...

20:40 Lifestyle

**Si të shmangni shpërthimin e pijeve të gazuara? Ja një truk i thjeshtë**

Kushdo që ka hapur një kanaçe pijeje të gazuar pasi ajo ës...

12:46 Lifestyle

**Mbahet ceremonia e çmimeve "Emmy"/ Zbulohen fituesit për vitin 2026**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.